



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE  
Nr. 1139 Prot.

Tiranë, më. 27.06 2022

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, dhe Vendimit Nr. 364, datë 29.5.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, Urdhërit të Kryeministrit, nr. 137, datë 21.10.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”. të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore shpall konkursin për pozicionin:

**SPECIALIST FINANCE NË SEKTORIN E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE  
MBËSHTETËSE,  
kategoria e pages IV-a**

**1. KUSHTET PËR KONKURIM DHE KRITERET E VEÇANTA:**

**1.1 Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shtuar sipas këtij ligji.

**1.2 Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Duhet të ketë arsimin e lartë me diplomë të Nivelit të Dytë të njohur nga Ministria e Arsimit të Shqipërisë, në degën financë. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo "Master Profesional" të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë në Financë. Diploma e nivelit Bachelor, duhet të jetë e të njëjtës fushë;
- Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në fushën përkatëse të diplomimit dhe 1-vit të ketë punuar në sistemin financiar buxhetor.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E KULTURËS**

**INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**

- c) Të jetë i specializuar në fushën e:
  - 1) standarteve të kontabilitetit,
  - 2) raportimit financiar,
  - 3) platformave të reja të aplikueshme në sistemin buxhetor SQDNE (Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik)
  - 4) sistemi tatimor e-filling,
  - 5) platforma qendrore e faturave elektronike,
  - 6) sistemin DAP/HRMIS,
  - 7) sisteme të integruara të proceseve të fiskalizimit të faturave, etj.
- d) Të njohë dhe zbatojë kodin e punës, kodin e procedurës administrative.
- e) Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE.
- f) Të ketë aftësi praktike të të punuarit në kompjuter, në rrjet / sistem, Internet, programe dhe softë: Windows, Word, Excel, Power Point, Adobe, intranet, Sistemi kontabilitetit Financa 5/ Alpha, etj.
- g) Të ketë aftësi të mira për: përshtatje pune në grup; të ketë aftësi të përmbushë detyrat brenda afateve të përcaktuara; aftësi komunikimi, referimi dhe mbrojtje të të dhënave, analizave, vendimeve, monitorimit dhe raportimit.

**2. PËRSHKRIM PUNE “SPECIALIST FINANCE NË SEKTORIN E FINANCËS  
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE,**

- 1. Përgatitja e listëpagesës për pagat mujore dhe raportet shëndetësore të punonjësve të IKTK-s, në sistemin HRMIS/DAP dhe e-tatime dhe dërgimi i raportave shëndetësore pranë Degës Rajonale të Sigurimeve Shoqërore;
- 2. Përpilimi i urdhër pagesave për shpenzimet e pagave, shpenzimeve operative dhe shpenzimet kapitale, si dhe ndjekja e veprimeve pranë Degës së Thesarit.
- 3. Rakordimi me Degën e Thesarit për shpenzimet periodike dhe të ardhurat të buxhetit të IKTK.
- 4. Realizimi i pagesave të taksave vendore në sistemin taksa vendore-Bashkia Tiranë.
- 5. Kontrolli dhe përditësimi i shërbimeve sipas detyrimeve ligjore në sistemin e-albania.
- 6. Administrimi i sistemit fiskal soft care për faturat tatimore fiskale të mallrave/shërbimeve të IKTK.
- 7. Harton bilancin kontabël dhe pasqyrat financiare vjetore për çdo vit ushtrimor.
- 8. Përgjigjet për administrimin e vlerave materiale dhe veprimet financiare të magazinës.
- 9. Regjistron veprimet në ditaret e shpenzimeve sipas standarteve të kontabilitetit:
  - a) Centralizator,
  - b) Ditar banke
  - c) Ditar magazine
  - d) Ditar shpenzimesh,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

10. Mban kartelat kontabël të inventarit të aseteve të Institucionit si dhe inventarin ekonomik sipas kartelave të punonjësve.
11. Rakordon llogaritë kontabël që preken nga regjistrimi i detyrimeve të konstatuara si dhe ndjek procedurën për mbylljen e veprimeve.
12. Përgatit listat e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat dhe realizon deklaratimet on line tek tatimet.
13. Përgatit listëpagesat mujore për anëtarët e KKTKM-së.
14. Përditëson raportimet financiare të projekteve të huaja që realizon IKTK.

**3. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë;

- a) Jetëshkrim i aplikantit;
- b) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- c) Fotokopje të noterizuar diplomës;
- d) Fotokopje të noterizuar të listës së notave;
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- h) Çertifikata kualifikimi;
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në protokollin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, **brenda datës 01.07. 2022.**

**4. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:**

Brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit në datën **05.07. 2022**, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, do të bëjë verifikimin paraparak të kandidatëve që plotësojnë kushtet për konkurim, dhe do të shpallë në faqen e internetit të saj, listën e kandidatëve të kualifikuar që vazhdojnë konkurimin, datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar, do të njoftohen me e-mail nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe kanë të drejtë të paraqiten prane tij për t'u njohur me arsyet e moskualifikimit.

Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

**5. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA:**

Kandidatët e kualifikuar për vazhdimin e konkurimit, do të vlerësohen për:

**- Njohuritë mbi:**

- a) Ligji nr.76/2016, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- b) Ligjin Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tij;
- c) Vendimin Nr. 364, datë 29.5.2019 të Këshillit të Ministrave "Për Funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore";
- d) Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- e) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- f) Njohuritë mbi Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- g) Njohuritë mbi Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
- h) Kodin e Procedurave Administrative;
- i) Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- j) Legjislacionin për Kodin e Punës dhe rregullat e etikës në administratën publike.

**6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore do ti njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë Institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në numrin e telefonit: +355 693893549,  
ose në adresën: Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore: "Rr. "Aleksander  
Moisiu" nr.76, Ish-Kinostudio, Tiranë, SHQIPËRI".

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**RUDINA ZOTO**

